



RREGULLORE MËSIMORE E PROGRAMIN TË STUDIMIT

MASTER PROFESIONAL NË INXHINIERI INFORMATIKE

Tiranë, Shkurt 2020



I. Të përgjithshme

Neni 1

Cikli i dytë i studimeve **Master Profesional në Inxhinieri Informatike**, është hapur për herë të parë në vitin akademik 2012 - 2013 me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr. 67, datë 12.02.2013, për "Një ndryshim në Urdhërin Nr. 539, datë 09.11.2012, Për hapjen e disa programeve të studimit "Master Profesional" në Universitetin Politeknik të Tiranës, i ndryshuar"

Neni 2

Masteri Profesional në Inxhinieri Informatike, ka për qëllim thellimin i njohurive të mara në sistemin e studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike, si dhe dhënie e njohurive të reja, për t'i pajisur studentët me njohuritë e nevojshme specifike në plotësim të nevojave të tregut të punës, të lidhura me teknologjitë e informacionit.

Neni 3

Masteri Profesional në Inxhinieri Informatike, është pjesë e studimeve të ciklit të dytë dhe është hapur pranë Departamentit të Inxhinieri Informatike në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, UPT.

Neni 4

Masteri Profesional në Inxhinieri Informatike, zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit të Universitetit Politeknik të Tiranës.

II. Organizimi

Neni 5

Masteri Profesional në Inxhinieri Informatike, realizohet në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT, 2019, Rregulloren e brendshme të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe drejtohet nga Departamenti i Inxhinierisë Informatike si njësi bazë e këtij fakulteti.

Neni 6

Detyrat e Departamentit të Inxhinierisë Informatike janë:

- Paraqitja e programit të studimit për miratim në Senatin e UPT
- Përgatitja e planit mësimor
- Rishikimi i programeve mësimore
- Hartimi i strukturës mësimore
- Menaxhimi i të gjithë aktiviteteve mbështesë për mbarëvajtjen e programit të studimit

Neni 7

Ambientet ku zhvillohet *Masteri Profesional në Inxhinieri Informatike*, janë pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, në korpusin universitar sheshi "Nënë Tereza", si dhe pranë laboratorëve të Departamentit të Inxhinierisë Informatike.



Neni 8

Masteri Profesional në Inxhinieri Informatike, kryen të gjitha regjistrimet e veta nëpërmjet Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit.

III. Pranimi i kandidatëve

Neni 9

Në Programin e Studimit *Master Profesional në Inxhinieri Informatike*, mund të regjistrohen vetëm personat që zotërojnë:

1. Diplomë të Ciklit të Parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) në Inxhinieri Informatike , të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjashme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisionet ad hoc që ngrihen nga departamenti;

Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

1. Regjistrohen fillimisht, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë FTI, UPT.
2. Nqs, pas pranimit të të gjitha kërkesave nga studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë FTI, UPT, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët e FTI që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni.
3. Nqs, pas plotësimit të pikës 2, të nenit 9, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët sipas diplomës Bachelor të fituar në UPT të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor.
4. Nqs, edhe pas plotësimit të pikës 3, të nenit 9, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët sipas diplomës Bachelor të fituar jashtë UPT, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor.

Neni 10

Tarifa e regjistrimit të kandidatëve është sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas detyrimeve që përcaktojnë rregulloret/urdhëresat e FTI/UPT. Kandidatët regjistrohen sipas procedurave të miratuara nga FTI/UPT.

Neni 11



Regjistrimet në Programin e Studimit *Master Profesional në Inxhinieri Informatike*, bëhen në zbatim dhe në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe vendimet e udhëzimet e ministrisë përkatëse. Ato kryhen pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit.

Neni 12

Njohja e krediteve bazohet në rregulloren e Universitetit Politeknik të Tiranës.

Neni 13

Ne Programin e Studimit *Master Profesional në Inxhinieri Informatike*, kanë të drejtë të regjistrohen shtetas shqiptarë ose të huaj. Këta të fundit, duhet të përmbushin të gjitha detyrimet/kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni përkatës në fuqi i Republikës së Shqipërisë dhe detyrimet/kërkesat që përcaktojnë rregulloret/urdhëresat e UPT/FTI.

IV. Zhvillimi i aktiviteteve

Neni 14

Programi i Studimit *Master Profesional në Inxhinieri Informatike*, zhvillohet me kohë të plotë. Ai zgjat një vit akademik. Kohëzgjatja maksimale e studimeve nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i ohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet. Viti akademik ndahet në dy semestra, zhvillohen lëndët sipas programit mësimor të miratuar. Në semestrin e dytë zhvillohen gjithashtu praktika profesionale dhe mbrojtja e diplomës, mikrotezës, si punim i pavarur i studentit të Programit të Studimit *Master Profesional në Inxhinieri Informatike*.

Neni 15

Gjuha në të cilën zhvillohet Programi i Studimit *Master Profesional në Inxhinieri Informatike*, është gjuha shqipe.

Neni 16

Leksionet zhvillohen në përputhje me orarin mësimor të aprovuar nga Dekani i FTI.

Neni 17

Kontrolli i dijeve në çdo modul bëhet nëpërmjet vlerësimit të detyrave të kursit, pjesmarrjes në laboratore dhe provës përfundimtare, provimit.

Neni 18



Masa e frekuentimit të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve përcaktohet në rregulloren e UPT, si dhe në rregulloren e brendshme të FTI.

Neni 19

Rezultatet e frekuentimit, provave përfundimare të moduleve dhe të mbrojtjes së mikrotezës regjistrohen në Sekretarinë Mësimore të Fakultetit të Teknologjise së Informacionit.

Neni 20

Në përfundim të Programit të Studimit *Master Profesional në Inxhinieri Informatike*, studenti pajiset me diplomë të firmosur nga Dekani i Fakultetit të Teknologjise së Informacionit dhe nga Rektori i UPT.

Miratur me vendim DII, Nr. 4, Datë. 19.02.2020.

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. Asoc. Elinda Meçe